



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40 të Ligjit mbi tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 14/80 dhe 42/86), nenit 3, al. 1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, al. 1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.08.2004 merr

V E N D I M
MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E
LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E FSHATIT NDËRKOMBËTAR NË
PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Fshatit Ndërkombëtar në Prishtinë, nr. 01-535-1280, të dt. 21.07.2003.

Neni 2

Neni 2, al. 2, i Vendimit mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e Fshatit Ndërkombëtar në Prishtinë, nr. 01-535-1280, të dt. 21.07.2003, ndryshohet dhe do ta ketë këtë përmbajtje:

“Lokacioni, nga al. 1 e këtij neni, përfshinë ngastrën kadastrale nr. 494/1, komuna kadastrale e Çagllavicës, ngastrat kadastrale nr. 1701/2, 1701/4, 1701/6 komuna kadastrale e Prishtinës, me sipërfaqe të përgjithshme të lokacionit prej 9.13.45 ha.”.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 353-2140 DT. 10.08.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri